

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur
(në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
5-janar-23		18.92			34.68
12-janar-23		12.18			27.94
19-janar-23		20.23			35.99
24-janar-23			1.59		32.64
26-janar-23		25.50			38.01
2-shkurt-23		20.68			33.20
9-shkurt-23		20.18			32.70
16-shkurt-23		22.48			35.00
23-shkurt-23		32.13			44.65
24-shkurt-23			2.63		43.00
2-mars-23		24.79			35.62
9-mars-23		18.02			28.85
16-mars-23		17.92			28.75
23-mars-23		24.75			35.58
24-mars-23			5.31		34.37
30-mars-23		26.06			35.68

Në tremujorin e parë të vitit 2023, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë ka rënë në 34.89 miliardë lekë kundrejt mesatarisht 44.60 miliardë lekë në tremujorin e mëparshëm


¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

dhe mesatarisht 40.76 miliardë lekë gjatë vitit 2022. Pas kësaj rënieje, mungesa është rikthyer rreth vlerave mesatare të 5 viteve të fundit, por tendenca në fund të tremujorit ka qenë për rritje të saj, kryesisht për shkak të akumulimit të lartë të likuiditetit në llogarinë e qeverisë dhe uljen e marrëveshjeve SWAP me Bankën e Shqipërisë.

Mungesa e likuiditetit, e shprehur sipas operacioneve injektuese të Bankës së Shqipërisë, ka qenë mjaft e lartë në 51.05 miliardë lekë në ditët e para të vitit, por me rritjen e shpenzimeve të Ministrisë së Financave, ka rënë në mes të muajit janar në 27.94 miliardë lekë, kur u shënuar edhe vlera më e ulët. Shpenzimet e rritura të MFE u financuan nga likuiditeti i akumuluar gjatë vitit 2022, rritja e marrëveshjeve SWAP në ditët e fundit të vitit 2022 dhe shitja e 50 milionë Eurove ndaj Bankës së Shqipërisë për shumën 5.74 miliardë lekë në muajin janar.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 22.33 miliardë lekë ose 64% kundrejt përkatësisht 60.65% dhe 55.4% në dy tremujorët e mëparshëm. Paralelisht me rënien e mungesës, injektimet 3-mujore janë ulur për total 6 miliardë lekë gjatë periudhës.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë




Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 15.06 miliardë lekë prej mesatarisht 10.04 miliardë lekë në gjashtë muajt e mëparshëm.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 20 raste për mesatarisht 2.1 miliardë lekë prej 9 raste për maksimalisht 2.2 miliardë lekë në tremujorin e mëparshëm dhe vetëm 1 rasti gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit parë të vitit 2023, portofoli i Bankës së Shqipërisë është rritur me 270 milionë lekë në 69.60 miliardë lekë, duke mos arritur vlerën e mesit të bandës 71.30 miliardë lekë.



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës nuk ka pasur operacione rregulluese.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2023, sikurse lajmëruar në 13 dhjetor 2022, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar 2 ankande për blerjen e valutës.

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2023

Data	Shuma Raundi I (në euro)	
1 17/02/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
2 17/03/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
3 11/04/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
4 20/04/2023	5-9 mln	
5 11/05/2023	5-9 mln	
6 26/05/2023	5-9 mln	
7 09/06/2023	5-9 mln	
8 21/06/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
9 06/07/2023	5-9 mln	
10 20/07/2023	5-9 mln	
11 04/08/2023	5-9 mln	
12 18/08/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
13 18/10/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
14 17/11/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
15 06/12/2023	5-9 mln	
16 20/12/2023	5-9 mln	(1 mo FW)

Gjatë vitit 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandëve 160-220 milionë Euro.

Në këtë lajmërim, janë publikuar jo vetëm datat e ankandëve dhe shumat përkatëse, por edhe ato ankande në të cilat, do të përdoret opsioni forward.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të parë, MFE ka maturuar marrëveshjen SWAP për 8.94 miliardë lekë dhe i ka shitur bankës së Shqipërisë 50 milionë Euro me çmimin 114.80 lekë.

Marrëveshjet e SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 50 mil Euro në 18 prill 2023

2. 50 mil Euro në 18 shtator 2023
3. 40 mil Euro në 20 tetor 2023
4. 45 mil Euro në 17 nëntor 2023

Gjatë tremujorit janë blerë 579 mijë Euro nga programi IPA.